



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



**Agjencia e Kosovës për Akreditim**  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency

Data: 06.07.2017

Ref.: 535/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 51-të, të mbajtur më 23 Qershor 2017, mori:

**V E N D I M**

- I. Riakreditohet Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” në nivel institucional për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2018.
- II. Riakreditohen programet e studimit të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini” për periudhën tre vjeçare, 1 tetor 2017 – 30 shtator 2020:
  - Edukim Fillor, BA, 240 ECTS, maksimumi 110 studentë për vit akademik;
  - Edukim Parashkollor, BA, 240 ECTS, maksimumi 60 studentë për vit akademik;
  - Gjeologji, BSc, 180 ECTS, maksimumi 60 studentë për vit akademik;
  - Hidrogeologji dhe Gjeologji Inxhinierike, MSc, 120 ECTS, maksimumi 15 studentë për vit akademik;
  - Informatikë Inxhinierike, BSc, 180 ECTS, maksimumi 160 studentë për vit akademik;
  - Inxhinieri Ekonomike, BSc, 180 ECTS, maksimumi 160 studentë për vit akademik;
  - Juridik, LLB, 240 ECTS, maksimumi 161 studentë për vit akademik;
  - Makineri Prodhuese, BSc, 180 ECTS, maksimumi 100 studentë për vit akademik;
  - Materiale, MSc, 120 ECTS, maksimumi 15 studentë për vit akademik;
  - Materiale dhe Metalurgji, BSc, 180 ECTS, (me specializime ne: Materiale; Metalurgji), maksimumi 60 studentë për vit akademik;
  - Metalurgji, MSc, 120 ECTS, maksimumi 15 studentë për vit akademik.
- III. Nuk riakreditohen programet e studimit të Universitetit të Mitrovicës “Isa Boletini”:
  - Banka, Financa dhe Kontabilitet, BA, 180 ECTS;
  - Menaxhment dhe Informatikë, BA, 180 ECTS.

- IV. Obligohet Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” që deri me 1 tetor 2017 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) ta dorëzoj planin e rekrutimit të stafit akademik, për vitin akademik 2017/2018, për arsyeje të pensionimit të mundshëm të stafit, apo për çfarëdo arsyeje tjetër.
- V. Obligohet Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” që deri me datë 1 dhjetor 2017 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

### Arsyetimi

Universiteti i Mitrovicës “Isa Boletini” ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për ri/akreditim institucional dhe të programeve të studimit: Edukim Fillor, BA, 240 ECTS, Edukim Parashkollor, BA, 240 ECTS, Gjeologji, BSc, 180 ECTS, Hidrogjeologji dhe Gjeologji Inxhinierike, MSc, 120 ECTS, Informatikë Inxhinierike, BSc, 180 ECTS, Inxhinieri Ekonomike, BSc, 180 ECTS, Juridik, LLB, 240 ECTS, Makineri Prodhuese, BSc, 180 ECTS, Materiale, MSc, 120 ECTS, Materiale dhe Metalurgji, BSc, 180 ECTS, Metalurgji, MSc, 120 ECTS, Banka, Financa dhe Kontabilitet, BA, 180 ECTS, dhe Menaxhment dhe Informatikë, BA, 180 ECTS me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Edukim Fillor	BA	240	Eliza Avdiu, Qerim Selimi, dhe Violetë Bardhi- Zeqiri
2	Edukim Parashkollor	BA	240	Merita Shala, Mimoza Shahini, dhe Besim Gollopeni
3	Gjeologji	BSc	180	Afrim Koliqi, Behxhet Shala, dhe Islam Fejza
4	Hidrogjeologji dhe Gjeologji Inxhinierike	MSc	120	Flurije Sheremeti Kabashi, Sabri Avdullahi, dhe Zenun Elezaj
5	Informatikë Inxhinierike	BSc	180	Faton Merovci, Milaim Zabeli, dhe Qamil Kabashi
6	Inxhinieri Ekonomike	BSc	180	Muzafer Shala, Hakif Zeqiri, dhe Sahit Surdulli
7	Juridik	LLB	240	Agron Beka, Halil Bajrami, dhe Islam Qerimi
8	Makineri Prodhuese	BSc	180	Ahmet Latifi, Avdi Salihu, dhe Besim Xhafa
9	Materiale	MSc	120	Ali Sadiku, Nurten Beligradi Deva, dhe Rrahim Maksuti
10	Materiale dhe Metalurgji	BSc	180	Muharrem Zabeli, Mursel Rama, dhe Musa Rizaj

11	Metalurgji	MSc	120	Nazmi Hasi, Nagip Murati, dhe Zarife Bajraktari Gashi
12	Banka, Financa dhe Kontabilitet	BA	180	Qazim Tmava, Shefket Jakupi, dhe Esat Durguti
13	Menaxhment dhe Informatikë	BA	180	Isa Tahiri, Bashkim Bellaqa, dhe Ajtene Abdullahu

AKA ka organizuar dy vizita të ndara në Universitetin e Mitrovicës "Isa Boletini" me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit të cekura me sipër. Vizita e parë është realizuar më 08.05.2017, me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Volker Gehmlich, Volker Frederking, Stephen Adam, Tauno Otto, Regita Bendikiene, dhe Tapio Heiskari. Vizita e dytë është realizuar më 26.05.2017 me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Michael Geistlinger, dhe Bettie Higgs.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2017 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Në lidhje me ri/akreditimin institucional, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë qar në dhënien e rekomandimit për vetëm një vit:

Ekipi i ekspertëve ka theksuar se Universiteti i Mitrovicës ka një deklaratë të misionit e cila është shumë e përgjithshme dhe kjo deklaratë nuk arrin të reflektojë nevojat e posaçme dhe kërkesat e regjionit. Andaj ekspertët rekomandojnë që universiteti të rishkruaj misionin dhe vizionin përmes një procesi të përshtatshëm duke konsultuar akterët e jashtëm dhe të brendshëm.

Ekspertët kanë deklaruar se në raportin e vet vlerësimit përmendet një seksion për strategjinë e implementimit të deklaratës së misionit mirëpo sipas tyre ky grup i objektivave strategjike ka shumë dobësi. Qëllimet e strategjisë nuk përfshijnë ndonjë afat kohor, përgjegjësitë për secilin veprim apo se si do të monitorohet progresi i arritur. Në fakt sipas ekspertëve strategjia e përmendur nuk adreson plotësisht 8 pikat kyçe të deklaratës së misionit të universitetit. Në anën tjetër ekspertët kanë mësuar se Universiteti aktualisht ka autonomi të kufizuar meqenëse ka statut të përkohshëm dhe se nuk ka liri për të vepruar si institucion i pavarur për shkak të marrëdhënies me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Megjithatë sipas ekspertëve, kjo nuk e parandalon universitetin që të rishkruajnë deklaratën e vet të misionit. Rrjedhimisht ekspertët rekomandojnë që universiteti urgjentisht të hartojë dokumentet dhe politikat e tjera, dhe një strategji të detajuar, të cilat dokumente mbulojnë mësimdhënien dhe mësim nxënien, hulumtimin, zhvillimin e stafit akademik, marrëdhënien e universitetit me industrinë, etj.

Në lidhje me programet e studimit Banka, Financa dhe Kontabilitet, BA, 180 ECTS dhe programin Menaxhment dhe Informatikë, BA, 180 ECTS, raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë qar në mos dhënien e rekomandimit për ri/akreditim:

Sipas ekspertëve për këto dy programe të studimit në Fakultetin Ekonomik nuk është theksuar ndonjë deklaratë specifike e misionit apo ndonjë veçanti tjetër në lidhje me rezultatet e të nxëniet të programeve,

me përshtatshëmrinë e tyre me universitetin në tërësi apo lidhjen që këto dy programe e kanë me regjionin. Ekspertët kanë mësuar gjatë vizitës se në fakt raporti i vet vlerësimit për këto dy programe është hartuar nga staf akademik part time dhe se raporti nuk paraqet situatën aktuale se si organizohet mësimdhënia dhe mësim nxënia. Në këtë drejtim ekspertët numërojnë disa gabime të raportit të vet vlerësimit sikurse gabime për gradën akademike të programeve, kohëzgjatjen e tyre, formën e studimit, ngjashmëritë mes lëndëve të ndryshme, dallimet mes emrat e lëndëve në tabelë dhe përshkrimeve të tyre, etj.

Për sa i përket përmbajtjeve të programeve, ekspertët kanë deklaruar se viti i parë i studimeve për të dy programet është identik, dhe gjithashtu në semestrat e radhës ndryshimet mes përmbajtjeve nuk janë të mëdha dhe nuk ka dallime si dy programe të ndara. Për më tepër sipas raportit rezultatet e të nxënimit duhet të përmirësohen sepse nuk janë shumë specifike, në disa raste ato mungojnë krejtësisht. Llojet e vlerësimeve janë më tepër të përgjithësuara dhe nuk reflektojnë rezultatet e të nxënimit për secilën lëndë. Po ashtu puna praktike për asnjërin nga programet nuk është paraparë si obligative, dhe se puna praktike rekomandohet për studentët. Mirëpo ekspertët nuk kanë gjetur dëshmi se studentët bëjnë punë praktike dhe se deri në cilën masë ajo praktikë njihet apo pranohet si pjesë e programit të studimit.

Për sa i përket stafit akademik, ekspertët kanë deklaruar se stafi është i motivuar megjithatë programi në Banka dhe Financa nuk ka profesor të rregullt apo profesor të asocuar. Andaj ekspertët kanë dyshime nëse programi mund të ofrohet mjaftueshëm si për nga aspekti kuantitativ ashtu edhe kualitativ. Sipas ekspertëve, është esenciale që stafi akademik të përmirësohet.

Përfundimisht ekspertët kanë deklaruar se këto dy programe nuk mund të vazhdojnë të ofrohen si të ndara mirëpo ekspertët rekomandojnë që këto dy programe të shkrihen në një program të vetëm i cili merr parasysh gjitha rekomandimet dhe vërejtjet e raportit të vlerësimit.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini";
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



---

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë